

TRAFIKIMI I FËMIJËVE ËSHTË NJË FENOMEN I PËRHAPUR NË TË GJITHË BOTËN

Trafikimi i fëmijëve kryhet nga rrjetet e kimit të organizuar për përfitime të mëdha materiale.

Fenomeni i trafikimit të fëmijëve është prezent në gjithë botën, ku më shumë e ku më pak. Në vendet e varfëra dhe në tranzicion fenomeni është më i përhapur.

Shqipëria mbetet vend burimi, tranziti dhe destinacioni për trafikimin e burrave, grave dhe fëmijëve kryesisht për shfrytëzim seksual dhe punë të detyruar.



Sipas Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë trafikimi i të miturve konsiderohet krim i rëndë dhe dënohet nga 10 - 20 vjet burgim.

Trafikimi i fëmijëve ndodh si brenda dhe jashtë vendit dhe ka për qëllim shfrytëzimin e prostitucionit ose formave të tjera të shfrytëzimit seksual, të punës ose shërbimeve të detyruara, skllavërimin ose formave të ngjashme me skllavërimin, vënies në përdorim ose transplantimit të organeve, si dhe formave të tjera të shfrytëzimit.

Sipas raporteve të UNODC-së:

- ➔ 78% e viktimave të trafikimit në të gjithë globin shfrytëzohen për punë të detyruar.
- ➔ 22% e viktimave trafikohen për shfrytëzim seksual dhe forma të tjera.



THE **ARISE** FOUNDATION

ASKUSH S'ËSHTË ZOT I ASKUJT!

THUAJ JO TRAFIKIMIT NË NJERËZ!

Broshura e përgatit nga Grupi i të Rinjve Gjrokastër në kuadër të projektit "Fuqizimi i të rinjve në reaktivitet për të zhvilluar fushata anti-trafikimi", i financuar nga "Arise Foundation" dhe staturat nga Organizata "Të Ndryshëm & Të Barabartë".

Përbajtja e kësaj materiali jo domosdoshmërisht garanton përkrahjen e "Arise Foundation" dhe Organizatës "Të Ndryshëm & Të Barabartë".

TRAFIKIMI I FËMIJËVE



FAKTORËT QË NDIKOJNË NË TRAFIKIMIN E FËMIJËVE:

- Varfëria
- Papunësia
- Emigracioni
- Dhuna në familje
- Niveli ulët arsimor
- Niveli i lartë i korrupsionit
- Paqëndrueshmëria politike
- Martesat e rreme, divorcet
- Humbja e sistemit të vlerave
- Dëshira për një jetë më të mirë

DISA TREGUES PËR TRAFIKIMIN E FËMIJËVE

Kur një fëmijë:

- shoqërohet me të panjohur më të rritur se vetja;
- rri i mbyllur në vetvete, i distancuar nga çdo grup shoqëror;
- ka një gjendje të rënduar psikologjike.
- rri në internet dhe komunikon me persona të panjohur;
- ka shenja dhune në trup;
- është i paregjistruar në gjendjen civile;
- nuk ka kontakte të familjes;
- nuk ka një vendbanim të qëndrueshëm;
- fle në rrugë ose lyp;
- frekuenton vende të njohura me aktivitete të paligjshme;
- është kapur duke vjedhur;
- ka shuma të mëdha parash në duar.

Si mund të parandalojmë trafikimin e qenieve njerëzore?

Informo veten dhe të tjerët në lidhje me trafikimin.

Kërko ndihmë nëse ndodhesh në një situatë të vështirë.

Kujdes në kontaktet me të panjohur.

Ndihmo njerëzit në nevojë.

Denonco çdo rast të dyshimtë trafikimi.

Linja Kombëtare kundër trafikimit:

116006

STOP TRAFIKIMIT TË QENIEVE NJERËZORE



Trafikimi njerëzor është tregtia e qenieve njerëzore dhe shfrytëzimi i tyre nga kriminelë për arsye përfitimi.